



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 363, Datë 07.12.2023

MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“ENERGY24” SH.P.K. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2354/2 prot., datë 05.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy 24” sh.p.k. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Energy 24” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2354/1 prot., datë 23.11.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 80, datë 31.05.2019.
- Ky aplikim është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Shoqëria “Energy 24” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe po ashtu ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Energy 24” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 16, për pikën 1, gërmat “a” dhe “c”, si dhe pikën 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 16 Rinovimi i licencës

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të bëjë çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë dhe nëse ka, ta depozitojë atë në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy24” sh.p.k., për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 01.06.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI